

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (13)

Komisioni i Badinterit mbrojti idenë e serbëve të Bosnjës

Ajo që kishte bërë komisioni ishte pajtimi se popullata serbe e Bosnjës kishte të drejtë të parandalonte krijimin e një Bosnje të pavarur dhe të pandarë, një rregull si ai i mëhershmi kur një pjesë e shtetit federativ mund të delegjitimizonte shtetin duke mos marrë pjesë në çështjet e tij

A mund të thuhet se ishin të qëlluara vendimet e marra nga Komisioni i Badinterit, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin është diskutuar. Ka të atillë që thonë se vendimet e Badinterit nuk përputheshin me ligjin ndërkombëtar, që “nuk lejon ndarjen në emër të vetëvendosjes për pakicat”. Teknikisht këto vendime nuk bazoheshin në vetëvendosje, por në të drejtën e ndarjes sipas Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1974 dhe të dokumenteve të njëjta. Megjithatë, Jugosllavia ishte shpërbërë në mënyrë të qartë. Vendimet e Badinterit intensifikuan procesin e paqartësive dhe nuk ngadalësuan rrëshqitjen drejt dhunës në Bosnjë. Këto vendime nuk u ndih-

muan as negociatorëve evropianë në gjetjen e një zgjidhjeje për gjendjen në Jugosllavi, por e bënë të kundërtën.

Në perspektivën afatgjate, pasojat e punës së komisionit sollën kundërthënie ndërmjet të drejtës për vetëvendosje dhe nevojës për ruajtjen e kufijve shtetërorë. Gjatë dekadës 90, BE-ja, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës bënë përpjekje për zgjidhjen e këtyre kundërshtive. Kur Woodrow Wilson, foli për vetëvendosjen e popujve, ai mendoi në krijimin e shteteve të reja, veçmas jashtë Perandorisë Austro-Hngareze. Kah viti 2000 evropianët arritën një botëkuptim të ri për vetëvendosjen, por brenda kufijve ekzistues, e që do të nëkuptonte të

drejtën e popujve për gjuhë, shkollim, e madje edhe administratë të veten, por jo edhe të drejtën e një shteti të ri. Vitet 90 shënuan një ekspansion të konsiderueshëm në gjetjen e zgjidhjeve për kundërthëniet mes parimeve të kufijve të pandryshueshëm dhe vetëvendosjes. Këshilli i Evropës krijoi Komisariatin e Lartë për të Drejtat e Pakicave, Konventën kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si edhe Karta evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare u jetësua po ashtu. Gjykata evropiane për të Drejtat e Njeriut u krijua dhe deri kah viti 2001 kanë kaluar rreth 14 mijë lëndë individuale për vit. Raportet e Badinterit ishin pjesë e rëndësishme e një procesi të gjatë që ka shpënë në pajtimin e koncepteve të kundërta.


Misteri i vendimeve të Komisionit të Badinterit ka qenë sugjerimi që Bosnja të ndërmarrë referendum për çështjen e pavarësisë. Më 1990 derisa Bosnja ishte ende pjesë e Jugosllavisë, organizoi zgjedhjet e para të lira që nga imponimi i komunizmit. Një hulumtim kishte nxjerrë shifrën prej 74 për qind të popullatës që mbështetnin vendimin e udhëheqësisë së Bosnjës për ndalimin e formimit të partive nacionaliste. Dëshira e shumicës së votuesve ishte që pas 50 vjetësh, ka ardhur koha për largimin e komunistëve, pa marrë parasysh se çfarë idesh do të mbrojë partia e re. Gjatë fushatës, partitë nacionaliste, që

në fakt ishin lejuar, flisnin për harmonizimin e marrëdhënieve ndërmjet popullatës së Bosnjës, por kur këto parti shënuan fitore bindëse në zgjedhje, pasuesit lanë qartë dhe shpejt kontrollin e administratës në duart e e tri partive konceptngushta. Pa ndonjë përvojë në politikën apo shtetësinë demokratike, liderët partiakë nuk kishin aftësi e as dëshirën që nevojitej për implementimin e një marrëveshjeje të negociuar. Kjo u vërtetua me Partinë Demokratike Serbe të Karaxhiqit, e cila me ndihmën psikologjike dhe materiale nga Serbia, vazhdimisht kundërshtonte ndërlidhjen serbe në Bosnjën e pavarur. Kur filloi lufta në Kroaci, diku kah fundi i verës 1991, enklavat serbe në Bosnjë filluan ta quajnë veten si entitet “autonom” dhe ftuan APJ-në që t'i mbrojë. Milosheviqi u përgjigj duke bartur kontrollin e APJ-së në Bosnjë në duart e serbëve të Bosnjës, kështu që gjatë armëpushimit ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë, që u arrit në janar 1992, elementët serbë në Bosnjë u armatosën mirë dhe ishin në posedim të një pjese të madhe të territoreve për të cilat pretendonin të jenë të tyre. Shteti i Bosnjës, ndërkaq ishte privuar nga mundësitë e veta për të shfrytëzuar forcën për të ruajtur integritetin e vet. Ishin këto kushte kur komisioni nënvizoi se “populli serb i Bosnjë-Hercegovinës” ka lëvizuar nga pozicioni në nëntor i mbetjes në

Jugosllavi, te një votim në dhjetor për krijimin republikës serbe të ndarë në Bosnjë si pjesë e shtetit federativ të Jugosllavisë, dhe përfundimisht në janar 1992, që të shpallë pavarësinë e plotë të Republikës Serbe. Ishte konkludim i qartë: kjo nuk do të mund të formohej po qe se të gjithë popujt e Bosnjës do të dëshironin një shtet të pavarur të Bosnjës.

Ky ishte një rezultat teknik mjaft i çuditshëm, që i shtoej situatës në terren në Bosnjë. Ka pasur edhe habi sesi komisionerët të cilët tashmë kishin pranuar papajtueshmërinë e serbëve, ndonëse një referendum do të stabilizonte situatën. Në fakt, ajo që kishte bërë komisioni ishte pajtimi se popullata serbe e Bosnjës kishte të drejtë të parandalonte krijimin e një Bosnje të pavarur dhe të pandarë, një rregull si ai i mëhershmi kur një pjesë e shtetit federativ mund të delegjitimizonte shtetin duke mos marrë pjesë në çështjet e tij. Në thelb, komisioni, edhe pse pa paramendim, pranoi pozicionin e serbëve se ata nuk duhet të jenë pakicë në një Bosnjë të bashkuar.

(Nesër: Çka rezultoi nga referendumi në Bosnjë? Si e përshkruan vëzhguesit ndërkombëtarë mënyrën si bashkësia ndërkombëtare e trajtoi shpërbërjen e Jugosllavisë? Cila ishte pasoja e vendimeve të Komisionit të Badinterit?)



Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (15)

Brenda rrethit të mafias

Eliot Ness ishte njeri i durueshëm. Ai besonte se momenti i duhur do të vinte së shpejti. Al Capone, ndërkaq besonte se ishte i përjetshëm

Në qershor të vitit 1930 shteti “Chicago Tribune”, Jake Lingle, amerikan e kishte bindur gazetarin ekcentrik të gazetës Capones. Lingle ishte njeri i lid-

hur me Caponen dhe me mafian. Ai i kishte dy-tri llafe me Caponen dhe kujtonte se mafiozi nuk do t'i bënte dëm. Prandaj, Lingle pranoi të takohej me detektivët e Nessit dhe 10 qershori u caktua si datë e takimit. Takimi nuk u realizua kurrë. Më 9 qershor, gazetari ishte gjetur i vdekur me një plumb në pjesën e prapme të kokës. Atë ditë Al Capone gjendej në Miami. Policët e morën në pyetje dhe ai u deklarua: “Gazetarët duhet ta luftojnë reketin e jo ta mbrojnë. Ndoshta, nuk jam njeri i përshtatshëm për ta thënë këtë, por vërtet kështu mendoj”. Mirëpo, derisa Lenlge po “flinte me peshqit”, dy agjentë të Nessit po infiltroheshin në bandën e Capones. Agjenti “De Angelo” (ai e kishte këtë emër të rremë) i veshur me rroba të shtrënja u paraqit në selinë e Capones në hotel “Leksington” dhe kërkoi punë. Pamja e tij ua kishte mbushur syrin “ushtarëve” të Capones. Ndërkohë, Qeveria ishte kujdesur që “të dhënat” për “De Angelon” të ishin të pastra. Ose më mirë të thuhet: të ndyra. Agjenti De Angelo e dinte fare mirë se po ta merrte vesh Capone



Al Capone i vriste tradhtarët me shkop beisbolli. Disa thonë se loja e beisbollit ka qenë pasion i tij i madh. Kjo fotografi e paraqet në rreshtin e parë, së bashku me gruan Mae dhe të birin Albertin, duke e shikuar një ndeshje beisbolli

se ishte spiun, do ta vriste me shkop beisbolli. Mirëpo, Capones as që po i shkonte mendja në atë anë. Agjenti tjetër me emrin e fshehtë “Graziano” u “bashkua”, po ashtu, me mafian. Ndërkohë, po bëhej gati gjykimi i Raffael Capones dhe De Angelo e Graziano mësuan se mafia po përgatitej t'i vriste dëshmitarët. Kjo bëri që shteti t'i mbronte më mirë dëshmitarët dhe Capone të dështonte t'i vriste siç kishte planifikuar. Megjithatë, puna e Grazianos dhe

e De Angelos ndihmonte për shumëçka, pos për ta futur në burg Caponen.

Eliot Ness ishte njeri i durueshëm. Ai besonte se momenti i duhur do të vinte së shpejti. Al Capone ishte njeri optimist. Ai besonte se nuk do ta arrestonin kurrë.

(Në numrin e ardhshëm: Si i merrnin shënimet dy agjentët e infiltruar? Çka bënte Capone për ta kthyer reputacionin e njeriut të popullit?)

Gangsterë të tjerë të shquar

Lucky Luciano

Charles “Lucky” Luciano ka qenë bashkëkohanik i Al Capones. Kishte ardhur në Itali si emigrant nga Italia dhe menjëherë si fëmijë kishte nisur t'u mbledhte “haraç” fëmijëve të tjerë të mëhallës. I vetmi që nuk i paguante haraç ishte Meyer Lensky, i cili do të bëhej shok me Lucianon dhe së bashku do të bëheshin të njohur si mafiozë të rreptë. Në vitet njëzet Luciano kishte nisur të punonte për grupet mafioze të Vito Genoveses dhe të Frank Costellos. Kur në luftën mes familjeve Masseria dhe Maranzano, Luciano e Lensky e vranë Masserian, Maranzano i shpërbleu duke e bërë Lucianon zëvendës të vetin. Maranzano donte të bëhej shef i të gjitha grupeve mafioze dhe ta mbante kontrollin mbi të gjitha. Luciano ishte i mendimit se duhej të bëhej një “decentralizim” i kontrollit mbi grupet kriminale. Prandaj, Luciano e vrau edhe Maranzanon dhe vetë u bë shefi i asaj që në atë kohë njihej me emrin “Sindikata”. Ndërkohë, eliminoi edhe një mafioz tjetër të shquar. Dutch Schultzin.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Lucky Luciano e ndihmoi shumë ushtrinë amerikane në luftën kundër fashizmit. Megjithatë, shteti amerikan e deportoi në Itali në vitin 1946. Ai nga Italia e udhëhoqte biznesin në Amerikë. Ndërkohë vrau Albert Anastasian, e detyroi Frank Costellon të “dilte në pension” dhe e rregulloi punën që të arrestohej shefi tjetër i mafias Vito Genovese. Lucky Luciano ka vdekur më 1962 në Napoli nga një sulm në zemër. Shteti amerikan e lejoi varrosjen e tij në SHBA.